



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo
Qeveria E Kosovës - Vlada Kosova - Government Of Kosovo
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera -Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistika Kosova -Kosovo
Agency of Statistics

Agjencia e Statistikave të Kosovës

Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare 2016

PËRMBAJTJA:

Përmbledhja e objektivave
Struktura e PVSZ 2016
Prodhimi

1. VLERËSIMI I PERFORMANCËS.....	6
1.1 Produktiviteti dhe efikasiteti	8
1.2 Prodhimi	11
1.3 Cilësia	12
1.4 Korniza e planifikimit.....	13
1.4 Korniza e planifikimit.....	13
1.5 Standardet e BE-së për cilësinë	16
1.6 Kënaqshmëria e përdoruesve.....	16
1.7 Përmbledhja e vlerësimit të performancës	16
2. PRIORITETET STRATEGJIKE	18
2.1 Zhvillimi i statistikave ekonomike	19
2.2 Fushat e tjera statistikore dhe ndërlidhjet e tyre	19
2.3 Tabela përmbledhëse e zhvillimit organizativ më 2015	21
2.4 Tabela përmbledhëse në zhvillimin e fushave statistikore në vitin 2015	22
3. PLANI I VEPRIMIT VJETOR 2016	27
3.1 Buxheti.....	27
3.2 Pasqyra e prodhimit	27
3.3 Plani i Aktiviteteve	35

PËRMBLEDHJA E OBJEKTIVAVE

Misioni i ASK-së është të sigurojë të dhëna cilësore në kohë dhe statistika zyrtare relevante, që i përmbushin nevojat e të gjithë shfrytëzuesve vendorë dhe ndërkombëtarë.

Përgatitja e Planit Vjetor 2016 rrjedh nga Ligji për Statistika Zyrtare, respektivisht nga Programi i Statistikave Zyrtare 2013-2017 (Programi Pesëvjeçar i Statistikave). Përmes Planit Vjetor 2016, synohet realizimi i objektivave që kanë për qëllim shfrytëzimin më të mirë të burimeve përmes efikasitetit organizativ. Në këtë kontekst, Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare përcakton prioritetet operative nga Programi i Statistivave Zyrtare 2013-2017 (PSZ). Përcaktimi i prioritetëve bëhet duke synuar të arrihet efikasitet, produktivitet, rritje cilësore në sistemin statistikor, përmbushje e kërkesave të shfrytëzuesve dhe standardet e BE-së.

Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare në formën e re ka filluar që nga viti 2013 mbi bazën e Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017. Shikuar nga perspektiva e planifikimit dhe e monitorimit, për secilin vit janë caktuar objektivat përkatëse. Andaj, në këtë dimension, për herë të parë respektivisht për vitin 2013, PVSZ 2013¹ kishte vendosur objektivat e veprimit (sektori 6.2), që në masë të konsideruar janë realizuar, përderisa ato që ishin në progres, vlerësohen gjatë vitit 2014. Dhe, në këtë mënyrë realizimi i objektivave të secilit vit përkatës janë analizuar në vitin pasues, në këtë drejtim objektivat e veprimit për vitin 2015 do të vlerësohen gjatë vitit 2016.

Në kapitullin 4.3, Programi i Statistikave Zyrtare 2013-2017 (PSZ) cakton prioritetet strategjike, që paraqet kornizën e punës, në kuadër të së cilës vepron PVSZ. Andaj, ASK-ja duhet që gjatë periudhës strategjike 2013-2017 (sipas renditjes së prioritetëve) përmes planeve të veprimit vjetor ta:

1. fuqizojë planifikimin e ASK-së dhe ta finalizojë zbatimin e KVP-së, ta finalizojë riorganizimin e ASK-së dhe ta fuqizojë Departamentin e Planifikimit² dhe Departamentin e Regjistrimit dhe Anketimit;
2. themelojë një dialog sistematik me përdorues;
3. fuqizojë Teknologjinë Informativë (TI) dhe shërbimet mbështetëse;
4. zbatojë paralelisht metodologjinë e dokumentimit dhe proceset e prodhimit. Lidhur me këtë PSZ 2013 - 2017 përcakton prioritetet për zhvillimin e fushave statistikore, që janë sipas renditjes së prioritetëve.

Në kuadër të Kornizës së Burimeve Ekzistuese janë:

1. Llogaritë Kombëtare (PKSZ³),
2. Statistikat e Biznesit (PKSZ),
3. Çmimet (PKSZ),
4. Tregtia e Jashtme (PKSZ),
5. Anketa e Ekonomive Familjare Bujqësore (PKSZ),
6. Statistikat e tjera për individë dhe ekonomi familjare (PKSZ),
7. Vlerësimi Vjetor i Popullsisë (PKSZ),
8. Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP), PKSZ,
9. Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF), PKSZ,
10. Të dhënat administrative (PKSZ), dhe
11. Bilanci i Energjisë (PKSZ).

¹Agjencia e Statistikave të Kosovës, Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare 2013, 13 maj 2012.

² Emri i plotë i këtij departamenti është: Departamenti për Politika, Planifikim, Komunikim dhe Koordinim, por këtu e tutje i referohet si Departamenti për Planifikim.

³ Programi Kryesor i Statistikave Zyrtare (PKSZ) definohet përmes PSZ 2013-2017 me minimumin e kërkesave për prodhimin e statistikave, për t'i mbuluar nevojat bazë për vendimmarrje të Qeverisë. Nevojat e tjera për statistika, të shprehura nga përdoruesit kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si dhe nga Programi Statistikor i BE-së, do të ketë përparësi në Programin e Zgjeruar (PZSZ). Shih në vijim pjesën e pasqyrës së publikimit 3.2.

Plani Vjetor i Punës 2016

Jashtë Kornizës së Burimeve Ekzistuese:

1. SILC (PKSZ),
2. Regjistrmi i Popullsisë në katër komunitet veriore të Republikës së Kosovës, që nuk kanë marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë në vitin 2011. (PKSZ)

Ky dokument do t'i vë në funksion prioritetet e caktuara për vitin 2016.

Struktura e PVSZ 2016

Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare (PVSZ 2016) është i organizuar në tri pjesë:

1. Vlerësimin e performancës;
2. Prioritetet strategjike; dhe
3. Plani Vjetor i Veprimit.

Të tri pjesët do ta ndjekin logjikën e argumenteve, të bazuara në ciklin e planifikimit. **Së pari**, duke bërë vlerësimin e performancës së kaluar dhe ndikimet e tij për sistemin statistikor. **Së dyti**, duke hartuar vendimet e bazuara në vlerësimin e performancës, në formë të veprimeve, sipas prioritetit. **Dhe së fundi**, duke e vënë në theks, se çfarë do të thotë një plan veprimi me një buxhet, program të përgjithshëm statistikor dhe plan të aktiviteteve për vitin në fjalë.

Zbatimi i KVP-së ka filluar gjatë vitit 2014 dhe vazhdon të zbatohet në tërësi deri në vitin 2017, me modifikime të mundshme nga departamentet përkatëse. Ndërsa, objektivat e veprimit në kapitujt II dhe III do të zhvillohen konform objektivave strategjike të PSZ 2013-2017.

Prodhimi

Në bazë të Kalendarit Vjetor të Publikimeve 2014, ASK-ja ka prodhuar 46 produkte të saj të rregullta dhe produkte të tjera statistikore. Me Planin Vjetor 2015 janë planifikuar të prodhohen produkte shtesë (nga viti 2014) sipas objektivit në dokumentin strategjik, PSZ 2013-2017. Ndërsa, për vitin 2016 planifikohen edhe 2-3 produkte statistikore shtesë. Shumica e produkteve rezultojnë me statistikat e publikuara në kopje letër, ose të publikuara në ueb-faqen e ASK-së. Disa produkte janë të publikuara në periudha vjetore, tremujore a mujore, siç është rasti me Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK). ASK-ja siguron të dhëna për: Bruto Produktin Vendor, buxhetin e ekonomive familjare, punësimin, strukturën e fermave, statistikat agro-monetare, statistikat e mjedisit, strukturën ekonomike në Kosovë (SBS), çmimet, tregtinë e jashtme (eksportin neto) etj. Kalendarit i Publikimeve jep informata për datat e publikimeve në vitin vijues.

ASK-ja, po ashtu redakton, mirëmban dhe rishikon regjistrat statistikore vijues:

- Regjistrin e Popullsisë,
- Regjistrin e Ekonomive Familjare,
- Regjistrin e Banesave dhe Ndërtesave,
- Regjistrin Statistikor të Bizneseve,
- Regjistrin e Qarqeve Regjistruese,
- Regjistrin e Ekonomive Bujqesore,
- Regjistra dhe baza të tjera të të dhënave.

Plani Vjetor i Punës 2016

Disa produkte realizohen në bashkëpunim me agjenci të tjera publike.

Ligji i Statistikave Zyrtare në Kosovë, potencon se ASK-ja duhet të zhvillojë statistika sipas standardeve të BE-së. Qëllimi i prodhimit të statistikave është përmbushja e standardeve të BE-së, si në shtrirjen e produkteve ashtu dhe në cilësinë e statistikave. Raportet e lansuara nga BE-ja dhe të tjerë për ASK-në, rekomandojnë rritjen e sasisë dhe cilësisë së produkteve statistikore.

1. VLERËSIMI I PERFORMANCËS

ASK-ja, nga viti 2013 ka filluar ta zbatojë Kornizën e Vlerësimit të Performancës (KVP) së bashku me dokumentet për Planifikim (PSZ 2013-2017, PVSZ 2013, PVSZ 2014 dhe PVSZ 2015). KVP-ja mbulon disa aspekte të performancës dhe është e projektuar për ta përfunduar evidencën e bazuar në procesin e planifikimit, ku performanca e vërtetë lejohet të ndikojë në drejtimet vepruese.

Gjatë planifikimit për vitin 2016, në muajin maj 2015, ASK-ja duhet t'i vlerësojë prioritetet e saj të veprimtimit nga pikëpamja e performancës në të kaluarën. Pra, nga performanca e vitit 2014.

KVP-ja identifikon tetë (8) tregues kryesorë të performancës dhe katër (4) fusha të vlerësimit, duke i mbuluar aspektet, si: produktivitetin, përafrimin me BE-në, saktësinë në orar, afatet kohore, krahasueshmërinë dhe cilësinë. Disa tregues do të kenë vlera të vitit 2013 edhe në vitin 2014 (treguesit 4, 7 dhe 8) për shkak të kohës së nevojshme për t'i zhvilluar. Megjithatë, është bërë progres në këtë drejtim. Për treguesit 1-3 dhe për treguesit 5-6, statusi i tyre për 2012 veç është i ditur. Pasqyrat në vijim ilustrojnë statusin e tetë (8) të treguesve të KVP-së:

Treguesit e rezultuar	Statusi 2014	Synimi për 2017
1 Numri i produkteve	Rritja e prodhimit nga 39 produkte që ishin në 2012, në 46 produkte në 2014 (vëllimi i prodhimit në 2014 është rritur mbi 12% në krahasim me vitin 2012. Respektivisht, nga 79 në 103 publikime në 2014)	46 produkte (16 % rritje)?
2 Gjithsej numri i variablave	Për t'u mbledhur/grumbulluar nga përshkrimet e produkteve	Dokumentimi i variablave për 14 produkte në 2017
3 Gjithsej numri i treguesve kryesorë (BE- Lista e treguesve kyç statistikorë për vendet kandidate)	Numri i Treguesve kryesorë ka ndryshuar nëpër vite, në aspektin pozitiv rritës nga 38 tregues në vitin 2012, në 51 sosh në vitin 2014 (referenca: Doracaku i Eurostatit, edicioni 2014, 86 tregues) shprehur në % nga 45% në vitin 2012 në 59% në 2014.	20 % rritje (46)
Treguesit e rezultuar	Statusi 2014	Synimi për 2017
4 Ditë pune-për njeri/produkti	Viti i parë i regjistruar 2013, koha mesatare njerëz-ditë/për produkt ishte = 204 ditë/produkt. Ndërsa, në vitin 2014 koha mesatare (njerëz-dite për produkt ishte 157.2 ditë). Shprehur në % ulje për 22.9%.	25% reduktim (153).
5 Kalendari kohor, nga fundi i periudhës referuese deri në publikim/produkt	Nga të dhënat e prezantuara në SIPK, rezulton një rritje prej 9%, në krahasim me vitin e kaluar 2013	25% reduktim (58).
6 Shkalla e publikimeve në kohë	Norma e publikimeve në kohë është rritur nga 58 % në vitin 2012, në 80 % në vitin 2014. Ky është një përmirësim i rëndësishëm i cilësisë, respektivisht i publikimeve në kohë. Caku është 90 % e publikimeve në kohë deri në vitin 2017	90% e publikimeve në kohë
7 Seritë kohore të publikuara	Numri i tabelave/grafikëve në broshurën e BE-së, me të dhëna, së paku për tri vjet, ku është e përfshirë edhe Kosova. Për vitin 2014, Kosova ka të dhëna të	Seritë kohore të publikohen kurdo që është e mundshme

Plani Vjetor i Punës 2016

publikuara për tri vjet, ku shprehur në strukturë 49%, krahasuar me vitin 2012 që ishte 40%.

8 Vlerësimi i gabimit në mostër

Gjatë vitit 2014 ka filluar të llogaritet vlerësimi i gabimit në mostër dhe do të publikohet në vitin 2015

Vlerësimi i gabimit në mostër do të publikohet për 14 produkte, deri në vitin 2017

Shtojmë se, KVP-ja thekson katër aspekte të vlerësimit vjetor (duke përfshirë dhe qëllimet):

- a) Zhvillimin e planifikimit të kornizës së punës në ASK,
- b) Përafrimin me BE-në,
- c) Kënaqshmërinë e shfrytëzuesve,
- d) Njohjen për ASK-në.

Disa nga këto aspekte mund të reflektohen përmes 8 treguesve kryesorë (treguesi 3 jep numrin e treguesve statistikorë të kërkuar nga BE-ja, që prodhohen nga ASK-ja) dhe/ose mund të trajtohen përmes anketave. Aspektet *c)* dhe *d)* në të ardhmen do të varen nga zhvillimi i anketës/dialogut sistematik me shfrytëzuesit.

1.1 Produktiviteti dhe efikasiteti

Treguesit 4-6 mbulojnë aspekte të ndryshme të efikasitetit në produktivitet. Një ndër objektivat e ASK-së ka të bëjë me shfrytëzimin e burimeve të saj, me qëllim që prodhimi të bëhet në mënyrë progresive dhe më efikase, që do të thotë zvogëlim i angazhimit të ditëve të punës për njeri, shkurtim i kohës së prodhimit dhe publikimit të të dhënave kryesore në kohë. Qëllimet e vëna për 2013-2017 kanë synim të lartë, duke parashikuar përfitime nga një kornizë e përmirësuar e punës.


Për treguesit 1, 3, 5 dhe 6 në vitin 2012 të dhënat ekzistojnë dhe formojnë një bazë krahasimi për vitet në vijim.

KVP Treguesi 1 – Numri i produkteve

Statistikat kryesore të prodhuara në vitin 2014 janë 46 produkte, të rritura për 7 produkte më shumë se në vitin 2012. Nga këto 46 produkte kanë dalë gjithsej 103 raporte statistikore (muajore, tremujore, vjetore dhe dyvjeçare), nga 79 raporte që ishin në vitin 2012 (39/79). Gjatë vitit 2014, si prodhime shtesë ose produkte të reja janë llogaritur Kombëtare, respektivisht BPV-ja në baza tremujore.

Shkaqet ose arsyet e tjera për rritjen e publikimeve janë se për disa produkte është rritur periodiciteti i botimit (BPV-ja në baza tremujore, Statistikat tremujore të Industrisë, Statistikat tremujore të Indeksit të Kostos së Ndërtimit (IKN), Statistikat e Mirëqenies, statistikat sipas niveleve të arsimit). Në grafikun e poshtëshënuar është shfaqur trajektorja në drejtim të objektivit 2017. Në vitin 2013, prodhimi ishte pak më i lartë në krahasim me parashikimet, ndërsa në vitin 2014 rritja e produkteve ishte më e theksuar në krahasim me parashikimet.

Grafiku 1. Numri i produkteve të prodhuara në vitet 2012-2014



Sipas PSZ 2013-2017, objektivi është për një rritje prej 16% në vitin 2017, krahasuar me vitin 2012. Respektivisht, nga 39 produkte statistikore në vitin 2012 në 46 produkte në fund të programit në vitin 2017, e që tashmë është arritur numri prej 46 produkteve statistikore.

Grafiku 1 paraqet numrin e produkteve të prodhuara para se të lansohet PSZ 2013-2017. Pra, prodhimi në vitin 2012, që ishte 39 produkte; vlerësimi i performancës për vitin e parë me strategji, që është viti 2013, me 41 produkte; ndërsa, në vitin 2014 numri i produkteve të prodhuara ishte 46; si dhe trajektorja drejt qëllimit në vitin 2017, që është 46 produkte statistikore. Objektivi prej 16% rritje të produkteve statistikore është arritur, përkatësisht është përmbushur që në vitin 2014.

KVP Treguesi 4 – Ditë pune-njeri për produkt

Angazhimi i vërtetë i ditëve të punës për njeri, në prodhimin kryesor të vitit 2013 ishte regjistruar 204 ditë pune - njeri për produkt, me diferenca të theksuara, varësisht prej natyrës së publikimit. Koha e regjistruar do të përdoret si bazë për monitorimin e progresit, në drejtim të cakut (objektivit) 2017, për ta zvogëluar numrin e ditëve për njeri, për produkt, për 25% në 2017. Kjo do të thotë, nga 204 ditë pune - njeri, që është regjistruar në 2013, në 153 ditë pune - njeri në 2017. Pritjet për vitet 2015 dhe 2016 janë që të kemi zvogëlim të raportit ditor për produkt, në krahasim me rezultatet e vitit 2014. Në vitin 2013, koha e regjistruar, ditë pune - njeri për produkt, ishte 204, ndërsa në vitin 2014, kjo kohë është regjistruar 157.2 ditë pune-njeri për produkt e një ulje rreth 22.9%. Megjithatë, për shkak të numrit të ditëve që nuk janë raportuar, të dhënat aktuale nga SIPK-u, nuk prezantojnë numrin e ditëve –njerëzve për produkt, në mënyrë krejtësisht të saktë.

KVP Treguesi 5 – Afati kohor (koha prodhuese⁴)

Treguesi 5 - Afati kohor, po ashtu ka rol qendror për vlerësimin e rritjes së efikasitetit në prodhim. Ky tregues pasqyron të gjitha aspektet e proceseve, se sa mirë është i organizuar procesi i prodhimit, si një tërësi. Ky përfshin organizimin e forcës së punës, ndërlidhjen me përdorues dhe njësitë përkatëse të punës statistikore, si dhe marrëdhëniet me respondentët dhe agjencitë, që sigurojnë të dhënat hyrëse.

Që nga viti 2012, numri produkteve dhe i publikimeve ka shënuar një rritje të konsiderueshme. Krahasimet duhet bërë (përshtatur) vetëm me pruduktet dhe publikimet e njëjta. Andaj, për vitin 2014, nuk janë përfshirë të dhënat për të gjitha publikimet, por vetëm për ato që janë publikuar në vitin 2012, 2013 dhe 2014. Të dhënat për vitin 2014, tregojnë një rritje të kohës së përgjithshme prej 9%, e cila nuk është në linjë me objektivin e dëshiruar për vitin 2017.


Tabela 1 përmbledh situatën (kohën e prodhimit) për vitin 2014, krahasur me vitin 2013, për secilin departament. Të dhënat tregojnë dallime ndërmjet departamenteve për shumicën e publikimeve. Në statistikat ekonomike, të dhënat tregojnë një reduktim të kohës së prodhimit, në përputhje me pritjet. Koha e prodhimit në fushën e statistikave sociale derivon si pasojë e vonësës së mbledhjes së të dhënave nga burime të ndryshme administrative, si dhe problemet me analizat në Anketën e Fuqisë Punëtore (varësia të ekspertët e jashtëm). Në *Grafikun 2* është paraqitur trajektorja drejt objektivit 2017, që tregon progresin dhe pritjet e parapara me PSZ 2013-2017.

Tabela 1. Koha e prodhimit

Treguesi 5, viti 2014	Koha e prodhimit 2013	Koha e prodhimit 2014	Ndryshimi (+/-)	Synimi (-25%) 2017
D.SE	3346	2934	-12%	
D.SB	1102	1089	-1%	
D.SS	1483	2476	67%	
D.TI	280	273	-3%	
Gjithsej	6211	6772	9%	4709

⁴ Koha e prodhimit nënkupton numrin e ditëve, nga periudha referuese deri në ditën e publikimit

Grafiku 2. Koha e prodhimit 2013 - 2014 si dhe objektivi sipas PSZ 2013-2017



Në vitin 2012, koha e përgjithshme e prodhimit ishte 6278 ditë, ndërsa në vitin 2014, 6772 ditë. Pritja është reduktimi i kohës së përgjithshme e prodhimit për 25% në 5 vjet (4709). Sipas planit, koha e prodhimit e regjistruar në vitin 2014 duhej të ishte 5650 ditë (-10%).

KVP Treguesi 6 – Saktësia në kohë (shkalla e publikimeve në kohë)

Aspekti kryesor i publikimit të statistikave për përdoruesit kombëtarë dhe ndërkombëtarë është saktësia në kohë. Treguesi 6 regjistron shkallën e publikimeve në kohë. Plani strategjik i ASK-së ka caktuar si synim për 90% në vitin 2017. Publikimet në kohë tregojnë se nëse përdoruesit mund të presin statistika të disponueshme, siç janë paralajmëruar. KVP-ja do të monitorojë aspekte të këtilla përmes anketimeve të ardhshme për përdorues. *Tabela 2* përshkruan gjendjen e publikimeve në kohë në vitin 2013 dhe 2014.


Bazë për publikimin në kohë është Regjistrimi i Popullsisë/Vlerësimi për vitin 2012, ku 58% e publikimeve ishin publikuar në kohë. Ndërsa, në vitin 2014, situata është dukshëm më e mirë dhe ka rritje për 22%, respektivisht nga 58% në 80% të publikimeve të publikuara në kohë. Megjithatë, ASK-ja duhet ta shkurtojë kohën e prodhimit dhe ta rrisë numrin e publikimeve në kohë, deri në 90%. Kjo do të thotë se, deri në vitin 2017, ASK-ja duhet t'i publikojë 90% të publikimeve në kohë, pa asnjë vonesë.

Tabela 2. Publikimet në kohë

Treguesi 6, viti 2014, Departamentet prodhuese	Proporcioni i prodhimit në kohë 2013	Proporcioni i prodhimit në kohë 2014	Synimi 2017, 90%
DSELLK	74%	90%	
DSBM	71%	92%	
DSS	6%	32%	
DTI	56%	89%	
	60%	80%	

Në të dhënat e prezantuara në *Tabelën 2* shihet një ngritje domethënëse e shkallës së publikimeve në kohë, sipas fushave dhe viteve 2013-2014, si dhe synimi prej 90%, sipas PSZ 2013-2017. Në vitin 2012 më pak se 60% e publikimeve publikoheshin në kohën e paraparë (58%/ 2012).

Grafiku 3. Publikimet në kohë



Në *Grafikun 3* shihet qartë se norma e publikimeve në kohë në vitin 2012 ishte 58%, në vitin 2013 ishte 60%, ndërsa në vitin 2014 ishte 80%. Trajektorja e shfaqur në grafik tregon se norma e publikimeve në kohë është përmirësuar në bazë të objektivit sipas Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017. Në bazë të kësaj, ASK-ja duhet të përqendrohet në rritjen e publikimeve në kohë te disa departamente, në mënyrë që trajektorja të shkojë sipas kushteve të parashikuara të procesit prodhues.

1.2 Prodhimi

Siç është cekur në PSZ 2013-2017, ASK-ja në vazhdimësi planifikon ta përmirësojë gamën e prodhimit. Për ta matur zhvillimin e gamës së prodhimit dhe përafrimin me BE-në, janë përdorur tri masa:

- Numri i publikimeve,
- Numri i variablave, dhe
- Numri i treguesve kryesorë (Doracaku i Eurostatit).

Prodhimi i përgjithshëm është në rritje. Siç është treguar në pjesën e parë 1.1, numri i produkteve dhe publikimeve është rritur nga 2012 në 2014. Për ta klasifikuar normën e rritjes, megjithatë do të duhej të regjistrohet edhe numri i treguesve kyç të prodhuar. Ndërsa, lista e numrit të variablave duhet të bëhet gjatë procesit të dokumentimit të një numri të caktuar të produkteve.

KVP Treguesi 2 – Numri i variablave

Numri i variablave do të numërohen në nivel produkti, dhe çdo produkt duhet ta dokumentojë përshkrimin e produktit. Dokumentimi i variablave do të bëhet me një proces të veçantë, në kuadër të Projektit për Metadata. Megjithatë, faza fillestare e Projektit për Metadata (duke ndjekur standardet e BE-së, ESM) nuk përfshin një dokumentim të tillë të variablave. Në vend të kësaj, një bazë e shënimeve për metadata do të përdoret për mbledhjen dhe dokumentimin e variablave. Puna në krijimin e një baze të shënimeve për metadata mund të fillojë më vonë, respektivisht në vitin

Plani Vjetor i Punës 2016

2016-2017. Megjithatë, puna në definimin dhe dokumentimin e variablave mund të fillojë edhe para kësaj periudhe.


Për vitin 2015 është planifikuar që t'i kemi variablat e dokumentura për dy produkte. Për vitin 2016 planifikohet t'i kemi variablat e dokumentura për 4 produkte, ndërsa për vitin 2017, të jenë dokumentuar variablat për 8 produkte, që gjithsej janë 14 produkte me variabla të dokumentuara.

KVP Treguesi 3 – Numri i treguesve kryesorë (Lista e BE-së 2012)

Ky tregues është përcaktuar të jep një lloj vlerësimi për përafrimin me BE-në, duke monitoruar numrin e treguesve kryesorë, të publikuar nga ASK-ja në *Doracakun e BE-së për Vendet e Zgjerimit*.

Numri i treguesve të publikuar nga ASK-ja ka një rritje të lehtë ndër vite. Ka një rritje të të dhënave dhe tabelave të ASK-së, respektivisht të Kosovës, të përfshira në *Doracakun e BE-së për vitin 2014 (EU pocket book 2014)*. Kështu, në vitin 2014, Kosova ka qenë e përfshirë në këtë Doracak me 59%, krahasuar me vitin 2012, që ishte e përfshirë me 48%. Ky përmirësim paraqet përafrimin e Statistikave të Kosovës me BE-në, si dhe rritjen e vëllimit të prodhimit.

Grafiku 4. Pjesëmarrja e Kosovës në Doracakun e BE-së, shprehur në % me të dhëna në tabela dhe grafikë



Nga të dhënat e prezantuara në grafik, numri i të dhënave në tabela dhe grafikë, me të cilët përfshihet Kosova, ka një rritje tejte të rëndësishme. Nga 45% në vitin 2012, me një rënie të lehtë në vitin 2013, dhe me një rritje deri në 59% në vitin 2014, që ka tejkaluar edhe objektivin e vënë për 2017.

1.3 Cilësia

Sipas Ligjit për Statistika Zyrtare, statistikat zyrtare mund të grumbullohen, përpunohen, prodhohen dhe shpërndahen në bazë të standardeve dhe metodave të harmonizuara. Komponentët e cilësisë, që do të zbatohen janë: relevanca, saktësia, afatet kohore, saktësia në kohë, mundësitë për qasje dhe qartësia, krahasueshmëria dhe koherenca.

Plani Vjetor i Punës 2016

ASK-ja ka filluar ta zhvillojë një plan për ta menaxhuar përmirësimin e cilësisë dhe parimet për dokumentim/metadate. Kjo detyrë është që t'i inkuadrojë metodat statistikore, të pranuar nga BE-ja dhe nga komuniteti ndërkombëtar statistikor. Kjo do të bëhet hap pas hapi dhe duke shfrytëzuar rekomandimet nga Projekti i Binjakëzimit të komponenta e Menaxhimit të Cilësisë, si dhe mbështetjen e Statistikave të Suedisë për Metadate. Gjatë vitit 2016 do të finalizohet plani për përmirësimin e cilësisë.

Qëllimi afatgjatë është që të maten në tërësi të gjithë komponentët e cilësisë, në mënyrë që të arritet progres në sistemin statistikor dhe në plotësimin e standardeve të BE-së. Me PSZ 2013-2017 synohet të arrihet progres në: Seritë kohore dhe përmirësimin e Gabimit në mostër.

KVP Treguesi 7 - Publikimi i serive kohore

Një aspekt i rëndësishëm i cilësisë (dhe planifikimit) të statistikave zyrtare është mundësia për t'i krahasuar të dhënat nëpër kohë. Prandaj, të dhënat për seritë kohore do të shtohen në përshkrimin e produkteve të ASK-së. Një prodhim statistikor është konsideruar të ketë seri kohore, nëse tabelat e publikuara përmbajnë të dhëna për së paku tri vjet në seri. Numri i produkteve me seri kohore do të numërohen çdo vit dhe përmirësimet do të dokumentohen. Bazë krahasuese është numri i produkteve të publikuara me seri kohore në Doracakun e BE-së 2012. Numri i tabelave dhe i grafikëve në Doracakun e BE-së është rreth 35 sosh. Kosova është e përfshirë me të dhëna në seri kohore me 49% në 2014 në raport me 40% në vitin 2012.

KVP Treguesi 8 – Vlerësimi i gabimeve në mostër

Një ndër komponentët kryesorë të cilësisë është saktësia e të dhënave, respektivisht matja e intervalit të besueshmërisë së të dhënave statistikore. Për anketa me mostër, gabimi i mostrës do të dokumentohet në përshkrimin e produktit, kurdo që është e mundur në kuadër të Projektit 2013-2017 ndërmjet ASK-së dhe SIDA-s. Aktualisht, ASK-ja nuk e publikon gabimin e mostrës për anketa. Gjatë vitit 2014 kanë filluar të bëhen llogaritjet për Anketën e Fuqisë Punëtore dhe për Anketën e Bugjetit të Ekonomive Familjare, dhe për të njëjtat, publikimi do të bëhet gjatë vitit 2015. Vlerësimi i gabimit në mostër, në të ardhmen do të zbatohet edhe te anketat e tjera statistikore, fillimisht me Anketën e Ekonomive Bujqesore, etj.

Me PSZ 2013-2017 dhe planet vjetore është paraparë ulja në vlerësimin e gabimit në mostër deri në 20%.

Në kuadër të Projektit 2013-2017 është pjesa e gabimit në mostër. Andaj, si prioritet do të jetë nxjerrja e gabimit në mostër për të gjitha vlerësimet, e më pas të bëhet publikimi i gabimit në mostër për 2 produkte në vitin 2015, për 4 produkte në vitin 2016 dhe 8 produkte në vitin 2017.

Me qëllim të zbatimit të Parimit të Cilësisë nga Kodi i Praktikës mbi Statistikat Evropiane, KVP-ja do të zgjerohet me tregues të tjerë të cilësisë, normën e përgjigjeve të respondentëve, numrin e klikimeve dhe shkarkimeve në faqen e internetit të ASK-së.

1.4 Korniza e planifikimit

Korniza e planifikimit të ASK-së ka filluar të adresohet që në fillim të vitit 2012. Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur këto zhvillime kryesore:

1. Zhvillimi i instrumenteve të reja për procesin e planifikimit;
2. Riorganizimi i ASK-së, e veçanërisht krijimi i Departamentit të Planifikimit;
3. Draftimi i plotësim-ndryshimit të Ligjit për Statistika Zyrtare, sipas rekomandimeve të Eurostat-it;

Plani Vjetor i Punës 2016

4. Hartimi i Projekt-Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë në Komunitet Veriore të Kosovës, të cilat nuk kanë marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë 2011;
5. Hartimi dhe aprovimi i rregulloreve dhe udhëzimeve administrative;
6. Arritja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me institucionet e tjera.

1.4.1 Instrumentet e planifikimit

Parashikueshmëria dhe pasqyra e përgjithshme e prodhimit – si bazë për planifikim, prioritet dhe vendimmarrje – janë përmirësuar me publikimin e Programit të Statistikave Zyrtare, PSZ 2013-2017, Planin Vjetor 2013, Planin Vjetor 2014, Planin Vjetor 2015, dhe Kornizën për Vlerësimin e Performancës (KVP).

PSZ 2013-2017 përfshin një kornizë veprimi shumëvjeçare, prioritetet strategjike për zhvillimin organizativ dhe në fushën e statistikës, të cilat më parë pjesërisht kanë munguar. PSZ 2013-2017, po ashtu e definojnë Kornizën për Vlerësimin e Performancës, përfshirë edhe rezultatet kyçe nga prodhimi statistikor – kënaqshmërinë e përdoruesve, efikasitetin e prodhimit, cilësinë e produktit, etj. Struktura e PSZ-së 2013-2017, PVSZ-së dhe KVP-së ofron mundësi për një kornizë moderne të planifikimit, të bazuar në dëshmi, duke rritur orientimin e sistemit drejt rezultateve dhe duke ofruar bazën për:

- Procesin e prodhimit të dokumentuar – planifikim dhe zhvillim organizativ;
- Një dialog transparent dhe të vazhdueshëm me përdoruesit;
- Një dialog transparent dhe të vazhdueshëm me Këshillin Statistikor; dhe
- Krijimin sistematik të metadatave.

Korniza e integron planifikimin dhe raportimin, duke nënkuptuar se plani vjetor është i bazuar drejtpërdrejt në vlerësimin e performancës në të kaluarën.

KVP-ja, po ashtu krijon Sistemin e Përfshirjes së Kohës, për monitorimin e shpërndarjes së punës ditore për burime njerëzore. Raportet nga sistemi do t'u mundësojnë menaxherëve të ASK-së t'i identifikojnë vështirësitë dhe nevojat për kapacitete dhe t'i riaranzhojnë proceset e punës për një efikasitet sa më të madh. Ky sistem u ofron menaxherëve një pasqyrë të nevojshme për ta mundësuar bashkëveprimin ndërmjet njësive të ndryshme punuese të statistikës. Deri në vitin 2017, sistemi i përfshirjes së kohës do të avancohet në Sistemin për Menaxhimin e Performancës.

Si përmbledhje, Korniza e Planifikimit është zhvilluar si vijon:

Në vitin 2012, ASK-ja:

- Ka hartuar Programin e Statistikave Zyrtare, PSZ 2013-2017, për Sistemin Statistikor Kombëtar;
- Ka hartuar Planin Vjetor të Veprimit të orientuar drejt rezultateve për vitin 2013 (PVSZ 2013);
- Ka zhvilluar përshkrimin e proceseve të produkteve statistikore; dhe
- Ka hartuar Kornizën për Vlerësimin e Performancës (KVP).

Në vitin 2013, ASK-ja:

- Ka krijuar Departamentin e Politikave, Planifikimit, Koordinimit dhe Komunikimit;
- Ka krijuar Departamentin e Regjistrimit dhe Anketimit;
- Ka zbatuar Sistemin e Përfshirjes së Kohës (SIPK), për monitorimin e shpërndarjes së kontributit të burimeve njerëzore; dhe
- Ka bërë progres në përshkrimin e unifikuar të produktit (standard i BE-së).

Plani Vjetor i Punës 2016

Në vitin 2014, ASK-ja:

- Ka bërë draftimin e Koncept-dokumentit dhe draftin e parë të plotësim-ndryshimit të Ligjit mbi Statistikat Zyrtare, me qëllim të fuqizimit të pavarësisë së ASK-së;
- Ka bërë Plotësim-ndryshimin e Ligjit për Regjistrimin e Bujqësisë;
- Ka finalizuar dhe publikuar Raportin Vjetor 2013 lidhur me performacën e ASK-së në përputhje me KVP-në;
- Ka zhvilluar Anketën mbi Kënaqshmërinë e Përdoruesit;
- Ka vazhduar zhvillimin e kapaciteteve të vetëvlerësimit të performancës;
- Ka bërë progres në zhvillimin e sistemit të vetë të reagimit të menaxhmentit;
- Ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Në vitin 2015, ASK-ja ka planifikuar:

- Zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të Departamentit të Planifikimit dhe Bordit të Drejtorëve, për ta menaxhuar procesin e planifikimit (duke u përqendruar në efikasitetin e brendshëm dhe cilësinë statistikore);
- Zhvillimin e mëtutjeshëm të KVP-së dhe rritjen e kapaciteteve për analiza të performancës;
- Zhvillimin vazhdueshëm, sistematik dhe proaktive të platformave të TI-së për shpërndarjen e të dhënave (“user interface”);
- Menaxhimin e bazuar në rezultate (RBM);
- Dokumentimin e variablave dhe produkteve statistikore (metadata);
- Zhvillimin e Sistemit “Data bank”;
- Finalizimin e Strategjisë së Diseminimit;
- Shpalljen e rezultateve përfundimtare të Regjistrimit të Bujqësië, 2014.

Në vitin 2016, ASK-ja planifikon:

- Përmbylljen e procesit të Plotësim-ndryshimit të Ligjit mbi Statistikat Zyrtare dhe Projekt-Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë në katër komunat veriore të Kosovës, që nuk kanë marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesa 2011;
- Hartimin e Planit Vjetor për vitin 2017;
- Zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të Departamentit të Planifikimit dhe Bordit të Drejtorëve, për ta menaxhuar procesin e planifikimit (duke u përqendruar në efikasitetin e brendshëm dhe cilësinë statistikore);
- Zhvillimin e mëtutjeshëm të KVP-së dhe rritjen e kapaciteteve për analiza të performancës;
- Zhvillimin e vazhdueshëm, sistematik dhe proaktiv të platformave të TI-së për shpërndarjen e të dhënave (“user interface”);
- Menaxhimin e bazuar në rezultate (RBM);
- Dokumentimin e variablave dhe produkteve statistikore (metadata).

1.4.2 Riorganizimi

Riorganizimi i ASK-së është proces që ka filluar në vitin 2012 dhe si i tillë ka vazhduar edhe gjatë viteve 2013 dhe 2014. ASK-ja në vazhdimësi do të veprojë sipas Rregullores Nr. 01/2013 për riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ASK. Duke respektuar rregulloren në fjalë, është realizuar:

1. Krijimi i Departamentit të Politikave, Planifikimit, Koordinimit dhe Komunikimit (DPPKK) dhe i Departamentit të Regjistrimit dhe Anketimit (DRA);
2. Bashkimi i Departamenteve për Statistika Sociale dhe Popullsisë në një (Departamenti për Statistika Sociale, DSS);
3. Rritja e kapaciteteve në departamentet e tjera.

Plani Vjetor i Punës 2016

DPPKK është i funksionalizuar, kryen dhe zbaton të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat, sipas Rregullores për Riorganizim dhe planit të paraparë të punës në Programin e ASK-së. Gjatë vitit 2015 do të plotësohen të gjitha vendet e zbrazëta, të krijuara në ndërkohë nga shkuarja e stafit të ASK-së në pension. Në vitin 2016, në qoftë se nga institucionet kompetente aprovohen pozitat e kërkuara nga ASK-ja, do të krijohet një departament i Llogarive Kombëtare dhe do të rriten kapacitetet në departamentet prodhuese.

Riorganizimi në ASK do të jetë një proces i vazhdueshëm, duke e respektuar Rregulloren përkatëse për Riorganizim, me qëllim të plotësimit të kërkesave dhe nevojave të ASK-së, në veçanti, dhe Sistemit Statistikor në përgjithësi.

1.5 Standardet e BE-së për cilësinë

BE-ja ka rregullore të caktuar për çështjen e cilësisë. Cilësia, në përgjithësi përkufizohet me metodologjinë e prodhimit, cilësinë e përpunimit, saktësinë e të dhënave, kohën e duhur për publikimin e të dhënave, krahasueshmërinë, etj. ASK-ja është duke u angazhuar në vazhdimësi në plotësimin e standardeve të BE-së, duke u bazuar në rregulloret për cilësinë.

Për vitin 2015, ASK-ja ka planifikuar përmirësimin dhe zhvillimin e procesit të dokumentimit për metodat e prodhimit. Do të fillohet me një program, që përmban dy lloje të vlerësimit. Njëri është vlerësimi teknik, që përqendrohet në metodat dhe dokumentimin e prodhimit, dhe tjetri është i orientuar drejt përdoruesit, që synon ta përmirësojë kënaqshmërinë e përdoruesit, duke i plotësuar në vazhdimësi kërkesat e tyre. Shih kapitullin 2: Prioritetet strategjike.

Funksionimi i plotë i programit në këto dy lloje të vlerësimit, planifikohet të ndodhë gjatë vitit 2015. Në këtë rast, do të merren në konsideratë rekomandimet që rrjedhin nga Projekti mbështetës i Binjakëzimit, 2013-2015.

1.6 Kënaqshmëria e përdoruesve

Kontaktet me përdoruesit e të dhënave janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë dhe për zhvillimin e përmbajtjes së statistikave. Një mënyrë e rëndësishme për vlerësimin e cilësisë është matja e kënaqshmërisë së përdoruesve.

Gjatë vitit 2013, ASK-ja ka zbatuar një proces të matjes së kënaqshmërisë së përdoruesve përmes Komponentës së Komunikimit. Kjo formë e matjes së kënaqshmërisë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2014, madje është mbajtur një anketë mbi kënaqshmërinë me një numër të caktuar përdoruesish, rezultatat e së cilës janë analizuar nga ASK-ja. Gjithashtu, gjatë vitit 2015 dhe 2016, ASK-ja planifikon zgjerimin dhe avancimin e formave për matjen e kënaqshmërisë së përdoruesve përmes ndërtimit të një vegje në ueb-faqen e ASK-së dhe organizimin e takimeve me përdoruesit.

1.7 Përmbledhja e vlerësimit të performancës

1. Gjatë vitit 2014 numri i produkteve është rritur për 7 sosh, në krahasim me vitin 2012, respektivisht nga 39 në 46 produkte, si dhe janë publikuar 103 publikime në vitin 2014, përderisa ishin 79 publikime në vitin 2012.
2. Numri i variablave është proces, që do të vazhdojë me aktivitete gjatë procesit të dokumentimit (metadata). Mirëpo, do të bëhet përditësimi i listës së variablave. Ky proces

Plani Vjetor i Punës 2016

do të jetë sfidues për ASK-në deri në finalizimin e plotë të procesit të dokumentimit të variablave.

3. Koha e prodhimit ka shënuar rritje, si pasojë e vonesave në mbledhjen e të dhënave nga njësitë e tjera dhe varësia në publikimin e rezultateve nga konsulentët e jashtëm.
4. Publikimet në kohë kanë shënuar progres në fusha të caktuara të statistikave, në krahasim me një vit më parë, sidomos në fushën e statistikave ekonomike, atë të bujqësisë, si dhe në publikimet e tjera.
5. Koha e raportimit është proces i vazhdueshëm, i cili gjatë vitit 2014 ka shënuar progres.
6. Publikimi/përfshirja e Kosovës me të dhëna në Doracakun e BE-së ka shënuar rritje të madhe, si në vitin 2014 ashtu edhe në seritë kohore.
7. Vlerësimi i gabimit në mostër ka filluar si proces gjatë vitit 2014. Ndërsa, gjatë vitit 2015, ASK-ja ka planifikuar me publikimin e këtij vlerësimi të gabimit në mostër për dy produkte (AFP dhe ABEF).

2. PRIORITETET STRATEGJIKE

Në pjesën 4.3 të Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017 janë paraqitur prioritetet strategjike, të cilat ndahen sipas fushave organizative dhe statistikore. Lidhur me zhvillimin organizativ, plani pesëvjeçar përcakton 5 prioritete strategjike. Në vitin 2016, ato do të jenë:

Prioriteti 1. Forcimi i planifikimit të ASK-së dhe përcaktimi i Kornizës për Vlerësimin e Performancës (KVP)

Gjatë vitit 2016 do të vazhdohet me forcimin e planifikimit dhe të monitorimit, respektivisht Kornizës së Vlerësimit të Performancës si dy faza kryesore të procesit. Përveç avancimit të sistemit të SIPK-ut, si vegël menaxhuese në procesin e mbledhjes së inputeve dhe KVP-së, do të hartohen edhe raporte analitike mbi bazën e sistemit të SIPK-ut. Gjatë vitit 2015 do të fillohet me dy raporte analitike, ndërsa gjatë vitit 2016 do të rritet numri i tyre dhe rezultatet do të jenë bazë për vendimmarrje nga menaxhmenti i lartë i ASK-se, lidhur me mënyrën e riorientimit të aktiviteteve (inputeve) në proceset statistikore. Departamenti përgjegjës për zbatimin e këtyre synimeve do të jetë DPPKK. Bazuar në Ligjin mbi Statistikat Zyrtare dhe PSZ 2013-2017, ASK-ja me kapacitetet e saj funksionale harton Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare.

Prioriteti 2. Riorganizimi i ASK-së

Procesi i riorganizimit nga pikëpamja e funksionimit dhe efikasitetit është proces i vazhdueshëm, me qëllim të përmbushjes së misionit të ASK-së dhe nevojave të përdoruesve me të dhëna statistikore të besueshme, në kohë, të sakta dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht. Shikuar nga objektivat e Rregullores për Riorganizim, pothuajse riorganizimi si projekt/aktivitet gjatë 2014 dhe 2015, në ASK është kompletur me përmbushjen e qëllimeve kryesore (krijimi i dy departamenteve të reja, bashkimi i dy departamenteve në një të vetëm, ndryshimi gradual i rolit të zyrave rajonale, etj.). Në kuadër të Reformës së Administratës Publike të Kosovës, ASK-ja ka finalizuar klasifikimin dhe standardizimin e vendeve të punës sipas Legjislacionit në fuqi.

Riorganizimi do të vazhdojë edhe në vitin 2016 sipas prioritetëve të ASK-së në ngritjen e Departamentit të ri për Llogari Kombëtare, plotësimin dhe sistemin e pozitive të reja dhe atyre aktuale në ASK, me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të ASK-së, në përmbushjen e obligimeve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare.

Prioriteti 3. Komunikimi me përdorues

Synimi i ASK-së është vendosja e një dialogu sistematik me të gjithë përdoruesit e Statistikave Zyrtare. Kjo përfshin edhe vendosjen e një koordinimi dhe bashkëpunimi me institucionet, që janë burim dhe njëkohësisht përdorues të të dhënave të ASK-së. Për realizimin e këtij synimi, gjatë viteve 2015-2016, ASK-ja do ta ketë mbështetjen nga Projekti i Binjakëzimit dhe SIDA-s.

Momentalisht, ASK-ja është duke punuar ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Bankën Qendrore të Kosovës, si prodhues zyrtarë të statistikave. Gjithashtu, ASK-ja përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit (MeM) ka rritur nivelin e koordinimit dhe të bashkëpunimit me institucione, që janë shumë të rëndësishme lidhur me burimin e të dhënave administrative. Përmes MeM-ve priten të realizohen gjatë vitit 2015 dhe fillojnë së zbatuari gjatë vitit 2016. ASK-ja planifikon të ndërtojë instrumente të rëndësishme për përdoruesit e statistikave zyrtare. Koordinimi dhe bashkëpunimi me përdoruesit ka arritur një nivel të kënaqshëm bashkëpunimi, sidomos me takimet e rregullta të Këshillin Statistikor, ku janë të përfaqësuar shumë institucione qeveritare dhe joqeveritare.

Ashtu siç ishte planifikuar për vitet e kaluara, edhe gjatë vitit 2016 planifikohet që të vendosen forma të ndryshme të kontaktit me përdoruesit, duke përfshirë organizimin e Anktës së Kënaqshmërisë së Përdoruesve, seminareve dhe tryezave të rrumbullakëta, si dhe deri te informimi sa më i madh i përdoruesve të gjerë përmes metodave të ndryshme të komunikimit. Sa i përket bashkëpunimit me përdoruesit ndërkombëtarë, planifikohet që të thellohet bashkëpunimi edhe më

Plani Vjetor i Punës 2016

tej. Tashmë është krijuar praktikë, që çdo vit të mbahen takime të përbashkëta vjetore me të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe donatorët e ASK-së në fushën e statistikave. Në ndërkohë, përmes Programit eDAMIS, ASK-ja vazhdon dërgimin e të dhënave në Eurostat, sipas kërkesave dhe standardeve të BE-së.

Sa i përket vlerësimit të përdoruesve, ASK-ja do të shfrytëzojë seminare, tryeza të rrumbullakëta, konferenca dhe të gjitha format e tjera të komunikimit, në mënyrë që të arrihet të merret një vlerësim sa më real nga përdoruesit e Statistikave Zyrtare.

Në vitin 2016, përmes Anketës së Kënaqshmërisë së Përdoruesve planifikohet të merret një rezultat konkret, lidhur me kënaqshmërinë e përdoruesve të Statistikave Zyrtare. Kjo formë e re e komunikimit do të jetë e rregullt.

2.1 Zhvillimi i statistikave ekonomike

Gjatë dy viteve të fundit, 2013 dhe 2014, ASK-ja ka shënuar një progres në fushën e statistikave ekonomike. ASK-ja për herë të parë ka arritur ta bëjë publikimin e BPV-së në baza tremujore në qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante. Ndërkohë, është bërë zbatimi i Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike në versionin NACE Rev. 2, parakusht për krahasimin e statistikave me vendet e Rajonit dhe më gjerë. Në vitin 2014 janë përpiluar dhe publikuar BPV-ja me sistemin e ri ESA 2010 dhe revidimi i llogarive ekzistuese. Po ashtu, është bërë progres në statistikafatashkurtra të biznesit, si dhe në vitin 2015 është në proces të finalizimit platforma e re e Regjistrimit Statistikor të Biznesit, etj.

ASK-ja ende ballafaqohet me vështirësi lidhur me numrin e limituar të statistikave afatshkurtra të biznesit, me cilësi të besueshme dhe në linjë me standardet e Bashkimit Evropian sipas metodologjisë ndërkombëtare. Shqetësim tjetër i evidentuar është: publikimi i BPV-së sipas qasjes së përdorimit të tabelave të furnizimit dhe përdorimit (SUT), të publikuara për herë të fundit në vitin 2007; format e tjera (treguesit) të publikimit të BPV-së si transform të BPV-së nominale në Paritetin e Fuqisë Blerëse (PFB), etj.

Një nga prioritet kryesorë për ASK-në janë Statistikat Ekonomike, për të cilat do të ketë angazhim për ta rritur kapacitetin prodhues, së paku deri në vitin 2017. Angazhimet duhet të përqendrohen në shkurtimin e afatit të publikimit të BPV-së në baza tremujore, përmirësimin dhe avancimin e statistikave afatshkurtra të biznesit, përmirësimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve, vazhdimin e vënies në përdorim të klasifikimeve të reja ndërkombëtare (si PRODCOM etj.).

Varësisht prej mundësive buxhetore, gjatë vitit 2016 planifikohet realizimi i projekteve për matjen e ekonomisë informale në Kosovë. Në anën tjetër, Qeveria ka miratuar Strategjinë për Luftimin e Ekonomisë Informale.

2.2 Fushat e tjera statistikore dhe ndërlidhjet e tyre

Në raportet e Progresit të BE-së, në dy vite e fundit, për Kosovë theksohet se është bërë një progres lidhur me infrastrukturën statistikore dhe po ashtu rekomandohet që bashkëpunimi i ASK-së me institucionet e tjera duhet të rritet. ASK-ja duhet t'i përdorë në mënyrë kompetente të dhënat e disponueshme administrative për t'i përmirësuar statistikafatashkurtra lidhur me arsimin, shëndetësinë, demografinë etj. Por, ASK-ja duhet po ashtu ta marrë parasysh dhe ta sigurojë vijimësinë e ABEF-it dhe Anketën Strukturore të Fermave, pasi është krijuar një kornizë bazë e mirë përmes Projektit të Regjistrimit të Popullsisë dhe atij të Regjistrimit të Bujqësisë.

Plani Vjetor i Punës 2016

Koordinimi ndërmjet proceseve të ndryshme punuese duhet të përmirësohet në ASK. Gjatë periudhës së PSZ 2013-2017, tema e koordinimit të produkteve të ndërlidhura është një prioritet në fushën e zhvillimit të statistikave. Duhet të bëhen më shumë angazhime në rritjen e dobisë së të dhënave të papërpunuara nga fusha të ndryshme për të prodhuar tregues që kanë kuptim. Shoqëria kosovare ka nevojë të jetë e informuar më mirë se si po zhvillohet ekonomia dhe jeta sociale në vend. ASK-ja tani ka një bazë të dhënash nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të vitit 2011 dhe Regjistrimi i Bujqësisë, i vitit 2014. Projekte këto, që kanë përforcuar zhvillimin dhe koordinimin e proceseve statistikore. Gjatë vitit 2014, ASK-ja ka realizuar Projektin e Regjistrimit të Bujqësisë, ku rezultatet përfundimtare do të shpallen në shtator të vitit 2015. Të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë 2014 do të mundësojnë krijimin e Kornizës së mostrës për të gjitha anketat e ardhshme në bujqësi dhe do të mundësojë prodhimin e treguesve të rinj, respektivisht do të reflektojë në pjesëmarrjen më të madhe të Kosovës në Doracakun e BE-së.

Kur paraqitet nevoja për projektet, që donatorët shprehin interesim t'i realizojnë në Kosovë, ASK-ja sipas përgjegjësisë së saj ligjore dhe profesionale, do ta merr vendimin e duhur, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, me qëllim që Sistemi Kombëtar i Statistikave t'i ketë përfitimet e nevojshme.

ASK-ja duhet t'i rrisë kapacitetet ekzistuese, në mënyrë që t'i përafrojë statistikave të Kosovës me ato të vendeve të Bashkimit Evropian dhe standardeve të Eurostat-it. Për ta arritur këtë, duhet të krijohet mundësia e ndjekjes së metodologjive të reja, për t'i grumbulluar dhe përpunuar më shpejtë të dhënat statistikore. Gjithashtu, ASK-ja duhet ta marrë parasysh progresin e bërë nga agjencitë e tjera publike dhe t'i shfrytëzojë arritjet e tyre për interesat e saj.

2.3 Tabela përmbledhëse e zhvillimit organizativ më 2015

Zhvillimi organizativ duhet të synojë në përmirësimin e efikasitetit të prodhimit dhe PSZ 2013-2017 paraqet katër prioritete vepruese për vitin 2016:

Brenda Kornizës së burimeve ekzistuese	Objektivi dhe përgjegjësia	Statusi dhe plani i paraparë - maj 2015
1. Përdorimi i Kornizës së Vlerësimit të Performancës (KVP)	<u>Objektivi:</u> Krijimi i një pasqyre të përgjithshme për proceset statistikore në ASK, më qëllim të përforcimit të Kornizës së Planifikimit. <u>Përgjegjës:</u> DPPKK	<u>Statusi:</u> SIPK-u tashmë është funksional dhe plotësimi i i tij me kërkesat e reja nga departamentet do të vazhdojë. <u>Plani:</u> - Monitorimi në vazhdimësi i SIPK-ut për vitin 2015-2016; - Asistencë e vazhdueshme nga TI-ja në përdorimin e SIPK-ut nga stafi i ASK-së; - Gjenerimi i raporteve një mujore, tremujore dhe njëvjeçare, si dhe monitorimi dhe përdorimi i raporteve
2. Rritja e kapaciteteve profesionale të DPPKK-së.	<u>Objektivi:</u> Kompletimi me staf i DPPKK-së, ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve për planifikim, raportim dhe dokumentim. <u>Përgjegjës:</u> DPPKK	<u>Statusi:</u> Është zbatuar Rregullorja për Riorganizimin e ASK-së. Të gjitha pozitat në DPPKK kanë përshkrimet e tyre të punës, por ka nevojë për zhvillim. <u>Plani:</u> Trajnimi për zbatimin e përgjegjësiëve do të fillojë në vitin 2015 dhe do të vazhdojë edhe në vitin 2016 me mbështetje nga Sida/SCB.
3. Funksionimi i plotë i DRA-së.	<u>Objektivi:</u> Monitorimi/mbikëqyrja e punës në terren gjatë mbledhjes së të dhënave, me qëllim të rritjes së cilësisë së tyre. <u>Përgjegjës:</u> DRA	<u>Statusi:</u> Departamenti i i Regjistrimit dhe Anketimit është i plotësuar dhe funksionon plotësisht. Është realizuar lidhja e zyrave rajonale me ASK-në përmes rrjetit qeveritar të Teknologjisë Informative. <u>Plani:</u> ASK-ja planifikon për vitin 2016 ngritjen e kapaciteteve me qëllim të rritjes së cilësisë gjatë mbledhjes së të dhënave.
4. Zhvillimi i faqes për përdorues dhe mbledhja e informatave përmes pyetësorëve dhe anketave.	<u>Objektivi:</u> Përmirësimi i raporteve me përdoruesit, e posaçërisht me përdoruesit kryesorë dhe organizimi i seminareve për përdoruesit. <u>Përgjegjës:</u> DMTI-në në bashkëpunim me DPPKK	<u>Statusi&Plani:</u> Këto aktivitete do të jenë të vazhdueshme gjatë tërë vitit 2015-2016 në bashkëpunim me Sida/SCB-në dhe Projektin e Binjakëzimit.
Jashtë Kornizës së burimeve ekzistuese	Objektivi dhe përgjegjësia	Statusi dhe plani i paraparë - maj 2015
1. Inkuadrimi i Metadatave	<u>Objektivi:</u> Trajnimi i stafit që punon në ekepe, dhe iniciimi i dokumentimit. <u>Përgjegjës:</u> DMTI në bashkëpunim me asistencën teknike të Sida/SCB dhe Projektit të Binjakëzimit.	<u>Statusi&Plani:</u> Bashkëpunimi me projektin e Sida/SCB dhe atë të Binjakëzimit është duke vazhduar. AFP, ABEF, ASB dhe IÇK janë të dokumentuara sipas ESMS-së dhe në kuadër të projektit do të vazhdohet deri në përfundimin e të gjitha produkteve, sipas planit, deri në fund të vitit 2015.

Plani Vjetor i Punës 2016

<p>2. Koordinimi i veglave të të diseminimit.</p>	<p><u>Objektivi:</u> Sigurimi i asistencës teknike dhe i trajnimeve për organizimin e variablave dhe serive kohore. <u>Përqiejës:</u> DMTI</p>	<p><u>Statusi&Plani</u> : Bashkëpunimi me Sida/SCB-në dhe Projektin e Binjakëzimit është duke vazhduar. Aktualisht, ASK-ja është në proces të finalizimit të zbatimit të platformës PX Eeb, për ta mundësuar shpërndarjen e të dhënave statistikore.</p>
<p>3. Përdorim më i mirë i metodologjive statistikore.</p>	<p><u>Objektivi:</u> Sigurimi i trajnimit të vazhdueshëm dhe dokumentimi i të gjitha metodologjive dhe vlerësimet e tyre. <u>Përqiejës:</u> DMTI</p>	<p><u>Statusi:</u> Projekti i metadatave është duke u zhvilluar. Ka lëvizje në nxjerrjen e treguesit për vlerësimin e gabimit në mostër. SIPK-u është në proces të avancimit. Një aplikacion për çmimet e produkteve është duke u zhvilluar dhe kah mesi i vitit 2015 do të fillojnë punën dy praktikantë të rinj në fushën e TIsë. <u>Plani:</u> Gjatë periudhës së ardhshme planifikohet dokumentimi i proceseve metodologjike statistikore.</p>

2.4 Tabela përmbledhëse në zhvillimin e fushave statistikore në vitin 2015

Për zhvillimin e fushave statistikore, PSZ 2013-2017 për vitin 2016 parasheh këto aktivitete:

Brenda Kornizës së burimeve ekzistuese	Objektivi dhe përgjegjësia	Statusi dhe plani i paraparë në maj 2015
1.BPV (PKSZ)	<p><u>Objektivi:</u> 1.Objektivi kryesor gjatë viteve 2015-2016 do të jetë shkurtimi i kohës së publikimeve, rritja e numrit të produkteve the raporteve, përmirësimi i metodologjisë, respektivisht cilësisë së atyre eksistuese, etj.;</p> <p>2. Zhvillimi i mëtejme i modelit për BPV-në në baza i tremujore përmes asistencës së jashtme teknike. Për këtë objektiv kërkohet rritja e numrit të stafit.</p> <p><u>Përqiejës:</u> Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare (DSELLK).</p>	<p><u>Statusi:</u> 1.1 Shkurtimi i kohës së prodhimit ka shënuar progres, si dhe ka filluar publikimi i BPV-së në baza tremujore. Është bërë publikimi i serive kohore për BPV-në në baza tremujore (TM1 2010-TM1 2014), si dhe rishikimi i serive kohore për BPV-në vjetore (2008-2012). Po ashtu, është bërë përkohësisht rritja e stafit (me tre stazhierë nga Sida suedeze deri në shkurt 2016). Në vitin 2015 ka filluar mbledhja e të dhënave për përpilimin e tabelave përdoruese dhe ofruese (ang. SUT).</p> <p><u>Plani:</u> Planifikohet që në fund të vitit 2016 të shkurtohet afati i publikimit deri në t+90 ditë.</p> <p>1.2 Plani për vitin 2015-2016 është që të vazhdojë me shkurtimin e afateve të publikimit të BPV-së në baza tremujore, si publikime të rregullta.</p> <p>2.1 Përmirësimi i modelit të BPV-së në baza tremujore do të jetë në proces edhe për dy vitet e ardhshme (2015-2016)</p>
2. Anketa e Fuqisë Punëtore (PKSZ).	<p><u>Objektivi:</u> 1. Ngritja e cilësisë së të dhënave të AFP-së, si dhe publikimi i të dhënave në baza tremujore. <u>Përqiejës:</u> Departamenti i Statistikave</p>	<p><u>Statusi:</u> AFP-ja aktualisht publikohet në baza vjetore, në saje të asistencës teknike të Bankës Botërore. <u>Plani:</u> Për vitin 2016 planifikohet:</p>

Plani Vjetor i Punës 2016

Sociale (DSS)		<ul style="list-style-type: none">- Përditësimi i kornizës së mostrës çdo vit, tre muaj para fillimit të anketës në terren;- Publikimi i rezultateve të AFP-së në baza tremujore sipas kalendarit të BE-së;- Vazhdimi i asistencës teknike në kalkulimin e peshave;- Rritja e shkallës së monitorimit të grumbullimit të të dhënave në terren.
3. Statistikat e Bizneseve (PKSZ)	<p><u>Objektivi:</u></p> <p>1. Përmirësimi i mbulueshmërisë së Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve dhe Statistikave Afatshkurtra të Ndërmarrjeve. Përmirësimi i përzgjedhjes së mostrës, shkurtimi i afateve të publikimit, rritja e numrit të produkteve, rritja e cilësisë dhe zbatimi i klasifikimeve të reja.</p> <p><u>Përqiejës:</u> Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare (DSELLK)</p>	<p><u>Statusi:</u></p> <p>3.1. Tashmë ka filluar zbatimi i NACE Rev 2. Janë mbuluar aktivitetet ekonomike për Statistikat e Ndërmarrjeve në bazë të Metodologjisë së Eurostatit (rregulloreve të BE-së).</p> <p><u>Plani:</u> Planet për 2015-2016 janë rritja e produkteve (Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë, Bilanci i Energjisë në baza vjetore dhe Klasifikimi PRODCOM – Klasifikimi i produkteve); rritja e cilësisë, duke përmirësuar pyetësorët, përzgjedhjen e mostrës, mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave; dhe realizimi i Anketës për Azhurnimin e RSB-së.</p> <p>Trajnimi i stafit përgjegjës për Statistikat e Biznesit (SSN dhe SASH) me module të avancuara të excelit dhe llogaritjen e treguesve të kombinuar.</p> <p>Krijimi ose ndërtimi i një softëri aplikativ për Regjistrin Statistikor të Bizneseve është në fazën e ndërtimit. Mbledhja e të dhënave me pyetësorë dhe mostër të rishikuar është në proces për Statistikat e Ndërtimit. Në vitin 2015 është filluar me aktivitetet mbi Klasifikimin e produkteve PRODCOM dhe do të vazhdohet si aktivitet i rregullt edhe në vitet e ardhshme. Do të vazhdojë shkurtimi i afateve të publikimeve, me qëllim të arritjes së objektivave të PSZ 2013-2017.</p>
4. Çmimet (PKSZ)	<p><u>Objektivi:</u></p> <p>1. Shkurtimi i kohës së prodhimit për të gjitha indeksat e çmimeve.</p> <p><u>Përqiejës:</u> DSELLK</p>	<p><u>Statusi:</u></p> <p>4.1 Nga janari 2015 Indeksi i Çmimeve të Konsumit është harmonizuar sipas konceptit ndërkombëtar dhe publikohet si Indeks i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK).</p> <p><u>Plani:</u></p> <p>Gjatë vitit 2015-2016 planifikohet të zbatohet aplikacioni i ri softuerik për Indeksin e Çmimeve të Prodhimit dhe Indeksin e Çmimeve të Importit. Planifikohet, po ashtu, për vitin 2015-2016 është të vazhdohet shkurtimi i afatit të publikimit; të përgatitet inventarizimi mbi IHÇK-në; të vazhdohet me Paritetin e Fuqisë Blerëse (PFB) me pilot projektet e IPA 2012/14.</p>

Plani Vjetor i Punës 2016

5. Tregtia e jashtme (PKSZ)	<p><u>Objektivi:</u></p> <ol style="list-style-type: none">1. Shkurtimi i periudhës së publikimit.2. Mundësia e qasjes interaktive për përdoruesit e të dhënave. <p><u>Përqejgjës:</u></p> <p>DSELLK dhe DMTI</p>	<p><u>Statusi:</u></p> <p>5.1.Shkurtimi i kohës së publikimit të Statistikave të Tregtisë së Jashtme në baza mujore, tashmë është realizuar sipas PSZ 2013-2017</p> <p>5.2.Zbatimi i veglave të PC-Axis për diseminimin interaktiv të të dhënave të Tregtisë së Jashtme është kryer dhe pritet që gjatë vitit 2015 të jetë në dispozicion të përdoruesve.</p> <p><u>Plani:</u></p> <p>Do të vazhdohet me avancimin e platformës PX-Web</p>
6. Anketa e Ekonomive Familjare Bujqësore – Anketa e Kulturave Bujqësore, Bimore dhe të Blegtorisë (PKSZ)	<p><u>Objektivi:</u></p> <ol style="list-style-type: none">1. Shfrytëzimi i Kornizës së mostrës nga Regjistrimi i Bujqësisë dhe dizajnimi i anketave të bujqësisë, sipas rekomandimeve të Eurostatit.2. Shkurtimi kohës së prodhimit të rezultateve <p><u>Përqejgjës:</u></p> <p>DSBM</p>	<p><u>Statusi:</u></p> <p>6.1. Regjistrimi i Bujqësisë do të sigurojë të dhëna bazë në shtator të vitit 2015, që do përdoren për ta dizajnuar më mirë mostrën e AEFB/ Anketën e Kulturave Bujqësore-Bimore dhe të Blegtorisë.</p> <p><u>Plani:</u></p> <p>Është e nevojshme prania e asistencës teknike për këtë fushë.</p> <p><u>Statusi:</u></p> <p>6.2. Koha e prodhimit është 190 ditë.</p> <p><u>Plani:</u></p> <p>Qëllimi është të shkurtohet kjo kohë në 180 ditë.</p>
7. Statistikat e tjera për ekonomi familjare dhe individë (PKSZ).	<p><u>Objektivi:</u></p> <p>1 Rritja e numrit të treguesve për statistika të tjera për ekonomi familjare dhe individë, sipas kërkesave të organizatave ndërkombëtare.</p> <p><u>Përqejgjës:</u></p> <p>DSS</p>	<p><u>Statusi:</u></p> <p>7.1. Janë ofruar të dhëna sipas pyetësorëve të dërguar nga ILO, UNESCO, ETF.</p> <p><u>Plani:</u></p> <p>Plotësimi i pyetësorëve të ETF-së, EU-së, UNESCO-s, ILO-s dhe Bankës Botërore me qëllim të nxjerrjes së sa më shumë treguesve.</p> <p>Përditësimi i regjistrave nga burimet e brendshme statistikore, për t'i përmbushur kërkesat e organizatave të ndryshme dhe përdoruesve individualë, si: statistikave të shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe të tregut të punës.</p>
8. Vlerësimi i popullsisë në baza vjetore (PKSZ).	<p><u>Objektivi:</u></p> <p>1.Vlerësimi i popullsisë në baza vjetore dhe rritja e treguesve lidhur me vlerësimin e popullsisë.</p> <p><u>Përqejgjës:</u></p> <p>DSS.</p>	<p><u>Statusi:</u></p> <p>8.1. Vlerësimi fundit është vlerësimi i popullsisë për vitin 2013.</p> <p><u>Plani:</u></p> <p>Vazhdohet me përdorimin e të dhënave përfundimtare të Regjistrimit të Popullsisë 2011. Mirëpo, do të përdoren të dhënat edhe nga anketat e tjera, si: statistikave për lindjet dhe vdekjet; të dhënat për emigracion nga burimet vendore dhe ndërkombëtare, etj.</p>

Plani Vjetor i Punës 2016

9. Të dhënat administrative (PKSZ).

Objektivi:

1. Identifikimi i të gjitha burimeve të të dhënave administrative dhe marrja e tyre në formë elektronike.

Përgjegjës:

Të gjitha departamentet prodhuese dhe mbështetëse

Statusi:

Lista e institucioneve për furnizim me të dhëna administrative ekziston. Është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit (MeM) me MASHT-in. Në MeM janë vendosur rregullat e dërgimit të të dhënave. Ka vazhduar marrja e të dhënave administrative nga institucionet e ndryshme.

Plani:

Të nënshkruhet MeM me ARC-në, me Ministrinë e Drejtësisë dhe të modifikohet MeM me BQK-në dhe MF-në.

Publikimi i Statistikave të Arsimit të dalë si publikim i përbashkët ASK- MASHT.

Jashtë kornizës së burimeve ekzistuese

Objektivi dhe përgjegjësia

Statusi dhe plani i paraparë - maj 2015

8. Regjistrimi i Bujqësisë (PKSZ).

Objektivi:

1. Themelimi i Regjistrimit Statistikor të Fermave.

Përgjegjës:

DSBM

Statusi:

1.1. Regjistrimi i Bujqësisë është kryer, dhe ASK-ja ka shpallur rezultatet paraprake.

Plani:

Rezultatet finale është planifikuar të shpallen në shtator të vitit 2015 Gjatë vitit 2016 duke shfrytëzuar të dhënat nga RB dhe me asistencën teknike ndërkombëtare do të krijohet një regjistër statistikor i fermave. Ky regjistër do të përdoret për anketa të ardhshme të bujqësisë.

9. Regjistrimi i Popullsisë në katër komunat veriore

Objektivi:

1. Realizimi i Regjistrimit të Popullsisë, duke përfshirë edhe Pyetësorin nga Regjistrimi i Bujqësisë

2. Kompletimi i i regjistrave të nevojshëm

Përgjegjës:

DSS, DSBM dhe departamentet e tjera

Statusi: 2.1 Pas Vendimit të Qeverisë së Kosovës (datë 14.02.2014) ASK-ja ka filluar procedurat për realizimin e Regjistrimit të Popullsisë në komunat: Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveqan. Është bërë draftimi projekt-ligjit, në të cilin është përfshirë edhe pyetësori i Regjistrimit të Bujqësisë. Po ashtu, është bërë përgatitja e koncept-dokumentit dhe ASK-ja është në pritje të konfirmimit të mbështetjes financiare për këtë projekt nga Zyra e BE-së në Kosovë. Aprovimi i mbështetjes financiare është premtuar të bëhet nëse Qeveria i dërgon Kërkesë Zyrtare Zyres së BE-së.

Plani: Të realizohet ky projekt nga fundi i vitit 2015 dhe gjatë vitit 2016.

2.2 Planifikohet të kompletohet Regjistri i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave; dhe ai i Regjistrimit të Ekonomive Bujqësore, etj.

4. Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (PKSZ)

Objektivi:

1. Zhvillimi i Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës, si dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të ASK-së.

Përgjegjës:

DSS

Statusi: 3.1 Është bërë përgatitja e instrumenteve të kësaj ankete, si dhe është zhvilluar anketa pilot në terren. Raporti i anketës pilot do të dalë në nëntor të vitit 2015.

Plani: Anketa të zhvillohet në tremujorin e dytë të vitit 2016.

Ofrimi i asistencës teknike nga BE-ja, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale.

Ofrimi i trajnimeve shtesë për stafin vendor, me fokus të veçantë në aspektin e analizimit të të dhënave.

2.4.1 Përpunimi i Statistikave të Veçanta

ASK-ja është angazhuar në përpunim e Statistikave të Veçanta të statistikave zyrtare, në bazë të kërkesave të shfrytëzuesve vendorë/ndërkombëtarë. Sa i përket grumbullimit të të dhënave, ASK-ja do ta bëjë vetë mbledhjen e të dhënave nga fushat e Llogarive Kombëtare, Paritetit të Fuqisë Blerëse, Tregtisë së Jashtme, Statistikavë të Biznesit, për Anketën e Kostos së Punës, Indeksit e Kostos së Punës, Migrimin, shpërndarjen, mbështetje për përdoruesit nga Eurostati, Statistikat Vjetore të Kulturave Bujqësore, Statistikat e Prodhimtarisë Blegtorale, dhe për Statistikat Agromonetare.

Këto aktivitete nuk janë pjesë e Programit Kryesor të Statistikave Zyrtare. ASK-ja do t'i shfrytëzojë këto mundësi për t'i kontrolluar kornizat e veta të mostrave dhe të jetë pjesë e aktiviteteve rajonale. Këto aktivitete kanë kalendarin rajonal të tyre të punës. Nga ASK-ja nuk varet të vendosë për kohën, por mund ta organizojë punën, në mënyrë të mirëfilltë brenda organizatës dhe t'i shtojë burimet shtesë kur është e nevojshme.

ASK-ja është në proces të rishikimit të Udhëzimit Administrativ nr.08/2012, që ofron bazë ligjore të realizimit të këtyre statistikave.

3. PLANI VJETOR I VEPRIMIT 2016

3.1 Buxheti

Buxheti i ASK-së për vitin 2015: paga dhe mëditje, 834,829; mallra dhe shërbime, 320,450; shpenzimet komunale 31,875; ndërsa shpenzime kapitale, 0.00. Gjithsej 1,187,154.

Për vitin 2016, për t'i përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë, e posaçërisht për t'i rritur aktivitetet e tjera, ASK-së i nevojiten më shumë fonde, qoftë në kategorinë Mallra dhe Shërbime, me qëllim të shtimit të anketave, (shtesë rreth 270,000 EUR, ku përafërsisht të jetë 590,000 EUR⁵ në total); qoftë në kategorinë Paga dhe Mëditje (shtesë përafërsisht 181,000 EUR⁶), me qëllim të shtimit të kapaciteteve njerëzore; ose qoftë në kategorinë e Shpenzimeve Kapitale (shtesë përafërsisht 150,000 EUR).

Buxheti i ASK-së për vitin 2015 dhe planifikimi për vitin 2016:

Kategoritë/ viti	2015	2016
stafi	<u>139</u>	<u>168</u>
	Aktuale	Të nevojshme
Paga dhe Mëditje	834.829,00	1.015.441,00
Mallra dhe Shërbime	320.450,00	590.000,00
Shpenzime Kapitale	-	150.000,00
Shpenzime Komunale	31.875,00	37.500,00
Gjithsej	1.187.154,00	1.792.941,00

3.2 Pasqyra e prodhimit

Pasqyra përfshin gjithsej rezultatet e prodhimit të ASK-së. Kjo i informon planifikuesit dhe akterët për frekuencën e publikimeve, partnerët e jashtëm, shpërndarjen e vëllimit të punës, kohën prodhuese dhe ditët e punës si e hyrë në prodhim. Gjatë periudhës strategjike, pasqyra do të shfaqë një trend për zhvillimin e treguesve 4 dhe 5 të KVP-së në nivel produkti. Përfundimisht, plani pesëvjeçar ka vënë cakun për efikasitet në prodhim, me një reduktim në kohë për 25% deri më 2017.

Funksionalizimi i plotë i DPPKK-së dhe DRA-së është planifikuar të bëhet gjatë vitit 2015. Gjatë vitit 2016 është planifikuar të krijohet edhe Departamenti i Llogarive Kombëtare dhe plotësimi i pozitave me rëndësi të disa departamente prodhuese. ASK-ja, gjatë periudhës së ardhshme, planifikon edhe themelimin e Njesisë së Analizave, fillimisht e mbështetur nga donatorët.

Pasqyra mbyllet me përmbledhjen në nivel institucional të ASK-së.

⁵Anketat e tjera për matjen e informalitetit në Ekonominë e Kosovës

⁶Vlerësim për paga dhe mëditjet , per 29 pozita te reja (29punëtorë) .

Plani Vjetor i Punës 2016

STATISTIKAT EKONOMIKE

Programet	Departamenti	Prodhimet dhe shërbimet statistikore	Shpeshhtësia e publikimit	Partnerët nga jashtë	Koha e prodhimit 2014	Koha e prodhimit 2015-plan	Koha e prodhimit 2016-plan	BNJ(njerëz-ditë) 2014	BNJ(njerëz-ditë) 2015 plan	BNJ(njerëz-ditë) 2016 plan	Publikimet në kohë 2014
PKSZ	DSELLK	Anketa strukturore e biznesit SSB:4000 ndërmarrje1234	vjetore	ES, SCB		343	341	231,875	118	124	0
PKSZ	DSELLK	IÇIMP (TM1-TM4,2016) 150 ndërmarrje	Trem.	Sida/SCB	324	304	282	158,375	89	242	4
PKSZ	DSELLK	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit IÇP (TM1-TM4 2016) 150 ndërmarrje	Trem.	Sida/SCB	358	312	294	222,625	116	242	3
PKSZ	DSELLK	Stat. Afatshkurtra në Industri (TM1-TM4 2016) 200 ndërmarrje	Trem.	projekti i binjakzimit	682	354	339	181,375	165	302	1
PKSZ	DSELLK	Stat. Afatshkurtra në Ndërtimtari (TM1-TM4 2016) 200 ndërmarrje	nuk ka	Sida/SCB	0	0	0	174	165	297	0
PKSZ	DSELLK	Stat. Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë (TM1-TM4 2016) 200 ndërmarrje		ska	0	381	353	60	260	253	0
PKSZ	DSELLK	Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet në Kosovë	Trem.	ES	165	144	128	7	38	84	3
PKSZ	DSELLK	Freskimi i Regjistrit Statistikor të Bizneseve, 3 000 ndërmarrje	nuk ka	ska	0	0	0	80	78	69	0
PKSZ	DSELLK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	Mujore	Sida/SCB, ES	167	159	146	275,625	157	275	12
PKSZ	DSELLK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	vjetore	Sida/SCB, ES	176	170	160	10,5	47	45	1
PKSZ	DSELLK	Statistikat mbi Tregtinë e Jashtme	Mujore	ES	410	359	344	101,875	98	235	13
PKSZ	DSELLK	Statistikat mbi Tregtinë e Jashtme	vjetore	ES	175	170	161	0	48	43	1
PKSZ	DSELLK	BPV me qasje në shpenzime	vjetore	IMF	255	314	307	164	293	139	1
PKSZ	DSELLK	BPV me qasje në prodhim	vjetore	IMF	329	314	308	191,875	268	128	1
PKSZ	DSELLK	Llogaritë Qeveritare	vjetore	IMF	168	168	161	26,75	30	49	1
PKSZ	DSELLK	BPV sipas qasjes së shpenzimeve dhe prodhimit (tremujore)	tremujore	Projekti i Binjakzimit	249	846	573	363,5	1065	1189	1
PKSZ	DSELLK	Indeksi i Kostos së Ndërtimit (IKN) (TM1-TM4 2013) 150 ndërmarrje	tremujore	Sida/SCB	259	318	298	163,375	115	272	3
PKSZ	DSELLK	Bilanci i Energjisë, TM1-TM4 2013	tremujore	None	316	283	223	24,375	43	77	4
PKSZ	DSELLK	Statistikat mbi Transportin, TM1-TM4 2013	tremujore	None	140	140	140	151,75	76	105	4
PKSZ	DSELLK	Statistikat mbi Hotelierinë (TM1-TM4 2013) 110 hotele	tremujore	None	302	300	299	202,625	145	168	4
PKSZ	DSELLK	Rezultatet e Anketës së PRODCOM-it	vjetore	None	0	0	413	0	0	107	0
PKSZ	DSELLK	Bilanci Vjetor i Energjisë	vjetore	None	0	0	187	0	0	73	0
	DSELLK	Gjithsej:			4.475	5.379	5.457	2.792	3.414	4.518	91%

Plani Vjetor i Punës 2016

STATISTIKAT E BUJQËSISË

Programet	Departamenti	Prodhimet dhe shërbimet statistikore	Shpeshhtësia e publikimit	Partnerët nga jashtë	Koha e prodhimit 2014	Koha e prodhimit 2015-plan	Koha e prodhimit 2016-plan	BNJ(njerëz-ditë) 2014	BNJ(njerëz-ditë) 2015 plan	BNJ(njerëz-ditë) 2016 plan	Publikimet në kohë 2014
-	DSBM	Regjistrimi i Bujqësisë	nuk ka	-	-	-	-	696	461	80	-
PKSZ	DSBM	Statistikat Agromonetare /Çmimet e Prodhimeve Bujqësore	tremujore, vjetore	Sida/SCB	180	178	186	189	171	410	5
PKSZ	DSBM	Statistikat Agromonetare /Çmimet e Inputeve Bujqësore	tremujore, vjetore	Sida/SCB	198	166	205	31	0	394	5
PKSZ	DSBM	Statistikat Agromonetare /Llogaritë Ekonomike për Bujqësi	vjetore	Sida/SCB, ES	-	-	330	46	76	230	-
PKSZ	DSBM	Anketa e Mbeturinave Industriale (800 ndërmarrje)	vjetore	Sida/SCB	351	322	358	180	65	220	1
PKSZ	DSBM	Anketa e Mbeturinave Komunale (100 kompani publike dhe private)	vjetore	Sida/SCB	360	329	341	128	40	240	1
PKSZ	DSBM	Fakte mbi Mjedisin (Burime administrative)	çdo dy (2) vjet	Sida/SCB	153	145		167	129	220	-
PKSZ	DSBM	Statistikat e Ajrit-studim testues (Burimet administrative)	nuk ka	Sida/SCB	-	-	-	119	7	196	-
PKSZ	DSBM	Statistikat e Ujit (Burimet administrative)	nuk ka	Sida/SCB	-	-	-	-	-	108	-
PKSZ	DSBM	Anketa e Kulturave Bujqësore Bimore (5 000 ekonomi familjare dhe ferma të mëdha)	vjetore	Sida, Ekspert	360	190	151	95	163	134	0
PKSZ	DSBM	Anketa e Blegtorisë (5 000 ekonomi familjare dhe ferma të mëdha)	vjetore	Sida, Ekspert	-	-	151	-	-	128	-
	DSBM	Gjithsej:			1.602	1.330	1.722	1.651	1.112	2.360	92%

Plani Vjetor i Punës 2016

STATISTIKAT SOCIALE DHE TË POPULLSISË

Programet	Departamenti	Prodhimet dhe shërbimet statistikore	Shpeshhtësia e publikimit	Partnerët nga jashtë	Koha e prodhimit 2014	Koha e prodhimit 2015-plan	Koha e prodhimit 2016-plan	BNJ(njerëz-ditë) 2014	BNJ(njerëz-ditë) 2015 plan	BNJ(njerëz-ditë) 2016 plan	Publikimet në kohë 2014
PKSZ	DSS	Anketa e Fuqisë Punëtore (4800 EF-600 EA)	nuk ka	DFID	342	45	526	447	317	440	0
PKSZ	DSS	Anketa e Buxhetit Familjar: 2400 EF	vjetore	Sida/SCB	162	145	578	819	506	527	1
PKSZ	DSS	Anketa e Buxhetit Familjar (Statistikat e Mirëqenies Sociale)	vjetore	Banka Botërore	212	85	209	155	107	180	2
PKSZ	DSS	Statistikat e Arsimit 2015/2016	vjetore	Sida/SCB	549	0	374	326	141	325	0
PKSZ	DSS	Statistikat e Jurisprudencës	vjetore	nuk ka	567	405	387	321	257	340	1
PKSZ	DSS	Statistikat Shëndetësisë	vjetore	nuk ka	309	318	193	145	137	180	1
PKSZ	DSS	Statistikat mbi Kulturën dhe Sportin	vjetore	nuk ka	655	310	210	197	151	195	1
PKSZ	DSS	Statistikat e Lindjeve: 34,000 formularë	vjetore	nuk ka	303	154	137	126	71	140	0
PKSZ	DSS	Statistikat mbi Vdekjet: 9,000 formularë	vjetore	nuk ka	251	171	120	114	51	96	0
PKSZ	DSS	Statistikat e Kurorëzimeve: 17,350	vjetore	nuk ka	350	189	100	86	31	78	0
PKSZ	DSS	Statistikat e Shkurorëzimeve: 1,500	vjetore	nuk ka	322	189	149	135	21	120	0
PKSZ	DSS	Statistikat mbi Shkaqet e Vdekjeve: 14,790	çdo dy (2) vjet	UNFPA		0	116	100	6	98	0
PKSZ	DSS	Statistikat Gjinore	çdo dy (2) vjet	Sida/SCB		447	100	96	17	75	0
PKSZ	DSS	Vlerësimi i Popullsisë	vjetore	nuk ka			118	82	78	72	
PKSZ	DSS	Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës	vjetore	IPA			225		150	220	
	DSS	Gjithsej:			4.022	2.458	3.542	3.149	2.041	3.086	32%

Plani Vjetor i Punës 2016

DMTI- DISEMINIMI

Programet	Departamenti	Prodhimet dhe shërbimet statistikore	Shpeshhtësia e publikimit	Partnerët nga jashtë	Koha e prodhimit 2014	Koha e prodhimit 2015-plan	Koha e prodhimit 2016-plan	BNJ(njerëz-ditë) 2014	BNJ(njerëz-ditë) 2015 plan	BNJ(njerëz-ditë) 2016 plan	Publikimet në kohë 2014
Brenda ASK-së											
PKSZ	DMTI	Buletini tremujor	tremujor	nuk ka	123	121	115	28	24	40	4
PKSZ	DMTI	Kosova në shifra	vjetore	nuk ka	150	272	274	18	25	27	1
PKSZ	DMTI	Katalogu i publikimeve	vjetore	nuk ka	78	78	78	26	44	28	1
PZSZ	DMTI	Kalendar/fletëpalosje/poster i publikimeve	vjetore	nuk ka				16	9	22	2
PZSZ	DMTI	Vjetari Statistior	vjetore	nuk ka			167			97	
	DMTI	Mbështetje për diseminim						710		1333	
	DMTI	Përfshirja e të dhënave						1193		1513	
PZSZ	DMTI	Mbështetje për metodologji						134		473	
PZSZ	DMTI	Mbështetje për GIS						116		473	
PZSZ	DMTI	Mbështetje për TI						239		1118	
	DMTI	Gjithsej:			351	471	634	2480	102	5124	89%

Plani Vjetor i Punës 2016

Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim (DPPKK)

Programet	Departamenti	Prodhimet dhe shërbimet statistikore	Shpeshësia e publikimit	Partnerët nga jashtë	Koha e prodhimit 2014	Koha e prodhimit 2015-plan	Koha e prodhimit 2016-plan	BNJ(njerëz-ditë) 2014	BNJ(njerëz-ditë) 2015 plan	BNJ(njerëz-ditë) 2016 plan	Publikimet në kohë 2014
PSZ	DPPKK	Plani Vjetor i Punës (Tn+1)	vjetore	SIDA	-	-	-	-	-	41	po
LSZ	DPPKK	Raporti Vjetor i Punes (Tn-1)	vjetore	SIDA	-	-	-	-	-	29	po
BN	DPPKK	Bashkëpunimi dhe koordinimi me donatorët	i vazhd.	MIE	-	-	-	-	213	45	-
PSZ	DPPKK	Draftimi i Hartes Rrugore	vjetore	nuk ka	-	-	-	-	4	11	Po
PSZ	DPPKK	Monitorimi i SIPK-ut	mujore	nuk ka	-	-	-	-	24	36	-
	DPPKK	Raporti mujor - SIPK	mujore	nuk ka	-	-	-	-	48	36	-
PSZ	DPPKK	Raporti tremujor - SIPK	tremujore	nuk ka	-	-	-	-	12	16	-
	DPPKK	Raporti vjetor - SIPK	vjetore	nuk ka	-	-	-	-	11	11	po
	DPPKK	Takimet/Raportet e aktiviteteve për stafin jashtë vendit	mujore	Eurostat	-	-	-	-	45	74	po
PZSZ	DPPKK	Projekti i Binjakëzimit	mujore	BE	-	-	-	-	48	18	-
	DPPKK	Raporti për komunikim dhe informim	i vazhd.	nuk ka	-	-	-	-	156	156	po
PSZ	DPPKK	Raporti për DPSA "Ekonomi, Kontroll Financiar, Statistika" 1 qershor (Tn-1) - 15 maj (Tn=0)	vjetore	MIE	-	-	-	-	-	19	po
PSZ	DPPKK	Inputi për Raportin e Progresit " 1 Korrik (Tn-1) - 30 Prill (Tn=0)	vjetore	MIE	-	-	-	-	-	19	-
PSZ	DPPKK	Plani Vjetor i Punës për Qeverinë TM1-TM4/2016 (PVPQ)	tremujore	ZKM, IRK	-	-	-	-	-	64	po
PSZ	DPPKK	Plani i Veprimit të MSA-së TM1-TM4/2016 (PVMSA)	tremujore	MIE, IRK	-	-	-	-	-	67	po
PSZ	DPPKK	Monitorimi i veprimeve për përmirësim, sipas rekomandimeve nga AGA&LPR për vendet e zgjerimit - Kosovës maj (Tn-1) - maj (Tn=0)	vjetore	BE/eurostat	-	-	-	-	-	20	po
BN	DPPKK	Mbledhja/pyetësori i të dhënave për Eurostat	vjetore	Eurostat	-	-	-	-	-	46	po
PSZ	DPPKK	PVZPQ	vjetore	ZKM	-	-	-	-	-	16	-
SHT	DPPKK	Të tjera (koordinimi brendshëm, grupe punuese, komisione të ndryshme, mbledhje bordi-misioni			-	-	-	-	-	120	-
	DPPKK	Gjithsej:							561	860	

Plani Vjetor i Punës 2016

Shërbimet tjera (ZKE)

